Kronikë

Nuk pranoi martesën me detyrim/ Babai, vëllai dhe i dashuri dhunojnë 29 vjeçaren në Vlorë

Ajo ishte fejuar me detyrim me djalin që babai i kishte zgjedhur, por refuzonte ta çonte këtë raport të padëshiruar, drejt martesës dhe jetesës në një shtëpi me dikë që nuk e donte.

Redaksia
22 Qershor, 10:17 | **Përditesimi: 22 Qershor, 12:56**

Share

Vlore- Një histori e dhunshme dhe e trishtë është shënuar ndaj një vajze 29-vjeçare në Vlorë, e cila është rrahur brutalisht nga burrat e shtëpisë së saj dhe vetë i fejuari, të cilin ia kishte zgjedhur familja, pa dëshirën e saj.

Nëse policia nuk do të kishte ndërhyrë, dhuna mund të kishte përshkallëzuar edhe më tej, nisur dhe nga fakti që në banesën e babait të vajzës u gjet një armë gjahu dhe municion luftarak.

Shkaku i dhunës fshihet tek kundërshtia e vajzës për tu martuar me djalin që familja i kishte zgjedhur. Ajo ishte fejuar me detyrim me djalin që babai i kishte zgjedhur, por refuzonte ta çonte këtë raport të padëshiruar, drejt martesës dhe jetesës në një shtëpi me dikë që nuk e donte.

LEXO EDHE:
Plazh dhe pickime! Rriten rastet e urgjencave në Vlorë, mjekët: Jo metodave popullore

Efektivët morën njoftim se një vajzë po dhunohej nga familjarët e saj dhe ndërhynë menjëherë në banesë duke arrestuar babain 60 vjeçar, vëllain 26 vjeç dhe të fejuarin e vajzës, 34-vjeçar. Të tre burrat u arrestuan nga policia ndërsa raportohet se 29-vjeçarja është në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

> *"Shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë, pas marrjes së njoftimit se një 29-vjeçare ishte dhunuar nga familjarët e saj, për motive të dobëta, në banesë, kanë ndërhyrë menjëherë për parandalimin e përshkallëzimit të dhunës.*
>
> *Si rezultat, shërbimet e Policisë kanë kapur dhe arrestuar shtetasit: A. B., 60 vjeç (babai), E. B., 26 vjeç (vëllai) dhe A. J., 34 vjeç (i fejuari). Nga veprimet hetimore dyshohet se për motive të dobëta, këta shtetas kanë ushtruar dhunë fizike ndaj 29-vjeçares, e cila është në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën",-njofton policia.*

K.M/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Vlorë

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Alibeaj iku nga grupi PD, çfarë duhet të bëjnë deputetët e tjerë pro Bashës?

Të ikin | Të qëndrojnë | Nuk e di

Lajme të tjera

Dyshohet se ka pirë mbidozë ilaçesh, 2-vjeçari dërgohet me helikopter nga Saranda drejt Tiranës
22 Qershor, 16:15

Basha: Partisë i mungon vetëm emri! Me apo pa vulë demokratët euroatlantikë do jenë në zgjedhje
22 Qershor, 13:56

Bllokohen 16 jet ski, skafe dhe gomone në Ksamil, Durrës, Shëngjin dhe Velipojë! Gjobiten me nga 100 mijë lekë drejtuesit e 6 mjeteve
22 Qershor, 12:24

Sarandë, 27 vjeçarit i gjejnë në shtëpi 2 kuti të mbushura me kapsolla elektrike detonatore
22 Qershor, 11:42

Temperaturat e larta 'shtyjnë' pushuesit drejt plazheve, trafik i rënduar në Vlorë, ja akset më kritike (VIDEO)
22 Qershor, 11:07

Zgjedhjet/ Aurela Saliaj zgjidhet rektore e Universitetit 'Ismail Qemali' në Vlorë
21 Qershor, 20:17

Një ditë perfekte në Sazan e Karaburun...por mungon infrastruktura
Armand Xhelili
21 Qershor, 17:03

Vlorë, shpërthen bombola e gazit, plagoset 62-vjeçarja
21 Qershor, 16:08

Vlorë/ Makina përplas 83-vjeçarin, i moshuari dërgohet drejt traumës në Tiranë
21 Qershor, 15:54

U dënua në Belgjikë për trafik droge, i konfiskohen 8 apartamente në Orikum të Vlorës dhe 2 llogari bankare me vlerë 260 mijë euro
21 Qershor, 14:25

Dy muaj hetime ndaj Jorgo Goros, SPAK depoziton informacionin në Gjykatë, avokati kërkon kohë! Shtyhet seanca për 26 qershor
Keti Banushi
21 Qershor, 11:58

Vlorë/ Asgjësohen 168 bimë narkotike, vihet në pranga 51-vjeçari
21 Qershor, 11:26

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje